



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-360 8435 dt. 23 02 2022

Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.pika 34.6, të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 3 pika 1.1.neni 4 pika 1.1.neni 7 pika 1, neni 12 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 13 të Ligjit Nr.03/L-164 Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit dhe Udhëzimet Administrative, kërkesës me Nr. 06-070/01-1722, të dt. 13.01.2022, Kuvendi i Komunës së Drenasit (Glllogocit), në mbledhjen e rregullt të mbajtur më **23.02.2022**, miraton këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e pikës 13 të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11.2019 të Kuvendit Komunal të Drenasit

Neni 1

1. Shfuqizohet pika 13 e nenit 1 të Vendimit të Kuvendit Komunal me Nr. protokoli 12-360-68569, të dt. 29.11.2019, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të *Banesës me Nr. 13, Kati II-të*, Blloku I në Drenasin III, për z. Muhamet Berbatovci.

Neni 2

Me këtë Vendim do të njoftohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, Zyra e Kryetarit dhe një mbetët për evidencë.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Web faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Republika e Kosovës / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration of Local Government	
Nr. Org. Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No
Nr. Dëgjues Dg. Shk. / Dg. Shk.	Nr. Dëgjues Dg. Shk. / Dg. Shk.
Nr. Pajisje No. Page	Nr. Pajisje No. Page
HYTËSE - ULTRANA - INCOMING	
BARKISHI, J. A.	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal / Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administration of Local Government	
Data / Datum / Date	
18.03.2022	
Njësia organizativë	Nr. i Lendes
-VL	000-1208/32

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit Milaim Hajdari, Kryesues e Kuvendit të Komunës së Gllogocit
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Venera Çerkini, Zëvendësues e Sekretarit të Përgjithshëm të MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
Nga:	Floriqe Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor MMPHI
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zytari konfirmues i Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit të Mbikëqyrjes e Zbatimit të Legjislacionit, të 2. Zytari hartues i Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së vendimit
Lloji i aktit:	Vendimi Nr.02-360-8435 për shfuqizimin e pikës 13 të nenit 1 të vendimit Nr. 12-360-68569, datë 29.11.2019, miratuar nga KK Gllogocit

I nderuari Kryetar Lladrovci,
I nderuari Kryesues Hajdari,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë (MMPHI) ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Nr.02-360-8435 për shfuqizimin e pikës 13 të nenit 1 të vendimit Nr. 12-360-68569, datë 29.11.2019. miratuar nga KK Glllogoc
--

I miratuar më datë: 23.02.2022

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 23.02.2022
--

I dërguar për shqyrtim në MMPHI më datë: 24.02.2022

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Arsyetimi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës, konstaton se në pikën 13 të nenit 1 të vendimit Nr. 12-360-68569, datë 29.11.2019, shprehimisht thuhet: *"Banesa nr.13 Kati II-të, i ipet në shfrytëzim të përkohshëm edhe për dy vjet Muhamet Bërbatovcit, nga fshati Godanc".*

Po ashtu, në shkresat e lëndës gjendet edhe kërkesa e shfrytëzuesit të përkohshëm z.Muhamet Bërbatovcit, Nr.06-070/01-1722, datë 13.01.2022, drejtuar Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komuna Glllogoc, në të cilën theksohet: *"[...] Kam bërë zgjedhjen e strehimit që katër muaj dhe jamë i gatshëm të dorëzoj çelësat e banesës [...]"*.

Nga ajo që u cek më lartë rezulton se organi komunal, përkitazi me këtë çështje ka vepruar në pajtim me kërkesën e shfrytëzuesit të përkohshëm të banesës sociale.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, mbetet në dispozicion të Komunës së Glllogocit dhe MAPL-së, për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.